

UDHËZIM
Nr.15, datë 7.7.2011

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.17, DATË 13.5.2008 “PËR TATIMIN MBI
VLERËN E SHTUAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.17, datë 13.5.2008 “Për TVSH-në” bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1.1:

Në germën “a”, paragrafi i parë ndryshon si më poshtë :

“a) çdo person fizik apo juridik që zhvillon veprimtari ekonomike, qarkullimi i të cilit për një vit kalendarik, tejkalon apo parashikohet të tejkalojë kufirin minimal të regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe çdo person fizik apo juridik importues, është i detyruar të regjistrohet.”

Në germën “b”, paragrafi i dytë shfuqizohet.

2. Në pikën 1.1.1 togfjalëshi “8 milionë lekë” zëvendësohet me togfjalëshin “kufirin minimal të regjistrimit për TVSH”.

3. Në pikën 1.1.2, germa “c” “Fillimi ose mbyllja e veprimtarisë ekonomike”, shembulli nga “Qarkullimi i tij nga 15 tetori...”, deri në fund, zëvendësohet me:.

“Qarkullimi i tij nga 15 tetori deri në fund të vitit është 1.100.000 lekë. Kufiri minimal i regjistrimit për një tremujor është $(5.000.000:365) \times 76 = 1.041.096$ lekë.

Në këtë rast personi është i tatuueshëm dhe duhet të kërkojë të regjistrohet.

4. Në pikën 8.5 “Organizatat jofitimprurëse”:

Në paragrafin 4, shprehja “8 milionë lekë”, zëvendësohet me shprehjen “kufiri minimal i regjistrimit”.

Paragrafi 5 ndryshon në përmbajtje, si më poshtë:

“Mallrat e importuara kundrejt pagesës së reduktuar si ndihmë humanitare nga organizatat bamirëse humanitare, institucionet e kultit, organizatat fetare apo filozofike, organizatat jofitimprurëse që gëzojnë statusin e organizatave për përfitim publik me qëllim kryerjen e furnizimeve siç përcaktohet në nenin 24 të ligjit, nuk ngarkohen me TVSH.”

5. Në pikën 11.1 të udhëzimit, paragrafi i tretë që fillon nga “Faturat tatimore të energjisë” deri në fund të paragrafit, ndryshon në përmbajtje si më poshtë:

“Në përputhje me udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Financave me Radiotelevizionin Shqiptar në faturat tatimore të energjisë elektrike, duhet të regjistrohet nën një zë më vete, tarifa mujore e shërbimit për përdorimin e aparateve televizive, vjelja e së cilës bëhet sipas udhëzimit të përbashkët.”

6. Në pikën 19.5 “Raste të veçanta për trajtimin e së drejtës për kreditimin e TVSH-së”, normativat e harxhimit të karburantit ndryshohen si më poshtë vijon:

NORMATIVAT E HARXHIMIT TË KARBURANTIT

I. NDËRTIM

a) Prodhim materiale inerte	deri më	33%
b) Ndërtim shtrim rrugësh	deri më	32%
c) Ndërtim banesash dhe objektsh të ndryshme	deri më	8%
ç) Prodhim betoni	deri më	14%
d) Gërmime / shpime	deri më	25%

II. TRANSPORT

a) Transport udhëtarësh	deri më	43%
b) Transport mallrash	deri më	38%

III. SHËRBIME

a) Autoshkolla	deri më	25%
b) Shërbime pastrimi qyteti	deri më	30%
c) Peshkimi	deri më	10%

III. TREGTI

deri më 3%

IV. TË TJERA (të palisuara më lart)

deri më 2%

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode